



Save the  
Children

# KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA MBI TË DREJTAT E FËMIJËS

## Neni 22: Fëmijët refugjatë

Në qoftë se unë kam qenë i detyruar të braktis vendin tim (refugjat), unë kam të njëjtat drejta si fëmijët e tjerë të atij vendi (të mbërritjes). Në qoftë se jam i pashoqëruar, unë duhet të marrë mbrojtje dhe mbështetje të veçantë. Nëse është e mundur, unë duhet të ribashkohen me familjen time. Unë kam të njëjtat drejta, edhe kur jam i detyruar të zhvendosem brenda vendit tim.

## Neni 23: Fëmijët me aftësi të kufizuara

Nëse unë kam një aftësi të kufizuar, unë kam të drejtë për mbështetje shtesë, kujdes dhe shërbime, në mënyrë që të mund të udhëheq një jetë të plotë dhe të pavarur në komunitetin tim, së bashku me njerëzit pa aftësi të kufizuara.

## Neni 24: Shëndeti dhe shërbimet shëndetësore

Unë kam të drejtë për kujdes shëndetësor me cilësi të mirë, ujë të sigurt, ushqim me kalori dhe një mjedis të pastër. Unë duhet të marr dhe të kem qasje në informacione që do të më ndihmojnë të qëndroj i shëndetshëm dhe mirë.

## Neni 25: Rishikimi i kushteve të jetesës

Nëse unë jam nën përkujdesjen e qeverisë time, unë kam të drejtë që kushtet e jetesës sime të rishikohen dhe kontrollohen rregullisht.

## Neni 26: Mbështetja nga qeveria ime

Unë kam të drejtë të marr mbështetje nga qeveria ime në qoftë se familja ime është e varfër.

## Neni 27: Standardi i jetesës

Unë kam të drejtë për një standard jetese që e plotëson rritjen time fizike, mendore dhe sociale. Kjo gjithashtu do të thotë që unë duhet të kem ushqim të mjaftueshëm, rroba dhe një vend të përshtatshëm për të jetuar.

## Neni 28: Arsimi

Unë kam të drejtë për arsimim fillor cilësor falas. Unë kam të drejtë për të ndjekur nivelin më të lartë arsimor nëse jam i aftë. Mësimdhënësit nuk janë të lejuar të më disiplinojnë duke përdorur dhunë fizike, mendore dhe emocionale të tilla si goditjet, sharjet, neglizhenca, fjalët abuzive apo ofenduese.

## Neni 29: Qëllimet e arsimit

Unë kam të drejtë në arsimim i cili zhvillon personalitetin dhe aftësitë e mia. Unë kam të drejtë në arsimim i cili respekton të drejtat, kulturën dhe vlerat e njerëzve të tjerë.

## Neni 30: Fëmijët e grupeve minoritare

Nëse unë vij nga një grup minoritar, unë kam të drejtë për të mësuar në gjuhën time si dhe të praktikoj fenë dhe zakonet e mia.

## Neni 31: Relaksimi, argëtimi dhe aktivitetet kulturore.

Unë kam të drejtë për t'u argëtuar, relaksuar si dhe të bashkohem në aktivitete të llojeve të ndryshme.

## Neni 32: Puna e fëmijëve

Unë kam të drejtë të jem i mbrojtur nga puna që është e rrezikshme ose që mund të dëmtojë shëndetin dhe arsimimin tim.

## Neni 33: Abuzimi me drogën

Unë kam të drejtë të jem i mbrojtur nga drogat e rrezikshme.

## Neni 34: Shfrytëzimi seksual

Unë kam të drejtë të jem i mbrojtur nga abuzimi seksual.

## Neni 35: Shitja, trafikimi dhe rrëmbimi

Askush nuk lejohet të më marrë me forcë, rrëmbejë ose të më shesë mua.

## Neni 36: Forma të tjera të shfrytëzimit

Unë kam të drejtë të jem i mbrojtur nga çdo formë tjetër e shfrytëzimit ose lëndimit të zhvillimit tim.

## Neni 37: Tortura dhe mohimi i lirisë

Nëse unë e shkeli ligjin, unë nuk duhet të ndëshkohem në mënyrë mizore ose lënduese. Unë kam të drejtë të mos vendosem në burg me të rriturit. Unë kam të drejtë të qëndroj në kontakt me familjen time.

## Neni 38: Konfliktet e armatosura

Unë kam të drejtë e mbrojtjes në kohërat e konfliktit apo luftës. Nëse unë jam një fëmijë, unë kurrë nuk duhet të detyrohem të marr pjesë në betejë.

## Neni 39: Shërimi, kujdesi dhe rehabilitimi

Unë kam të drejtë për mbështetje në qoftë se jam lënduar, neglizhuar apo keqtrajtuar.

## Neni 40: Zbatimi i drejtësisë për të miturit

Unë kam të drejtë për vetëmbrojtje në qoftë se jam i akuzuar për shkelje të ligjit.

## Neni 41: Respektimi i standardeve më të larta të ligjit

Unë kam të drejtë për mbrojtje sipas ligjeve në vendin tim ose sipas të drejtave në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijës, cila do që ka një standard më të lartë.

## Neni 42: Shpërndarja e konventës

Unë kam të drejtë për informacione dhe njohuri për të drejtat e mia në konventë. Këto të drejta duhet të ndahen dhe të vihen në dispozicion për të gjithë fëmijët dhe të rriturit.

“Të drejtat” u takojnë të gjithë fëmijëve si qenie njerëzore. Të gjithë fëmijët i kanë të drejtat e njëjta. Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijës i rendit këto të drejta. Të gjitha të drejtat janë të lidhura njëra me tjetrën dhe kanë rëndësi të barabartë.

Prindërit kanë përgjegjësinë primare për rritjen dhe sigurinë e fëmijës. Nganjëherë, të rriturit (prindërit, mësuesit, anëtarët e komunitetit dhe zyrtarët qeveritarë) po ashtu mund të vendosin se çfarë është e mirë për një fëmijë. Nëse prindërit nuk kanë mundësi t’i rrisin fëmijët, qeveria ka përgjegjësi për t’i mbështetur këto familjet. Derisa të rriten, fëmijët kanë më shumë shanse për të marrë përgjegjësi dhe për të ushtruar të drejtat e tyre.

Qeveria jonë ka përgjegjësinë përfundimtare për të zbatuar të gjitha të drejtat e renditura këtu. Prindërit dhe familja do t’i udhëzoj fëmijët.

#### Neni 1: Çfarë është një fëmijë?

Çdokush nën moshën 18 vjeçare i ka të gjitha të drejtat e përmendura në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijës.

#### Neni 2: Jo diskriminimi

Unë kam të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi. Kjo do të thotë se askush nuk mund të më trajtojë keq për shkak të paaftësisë sime, ngjyrës, gjinisë, kastës, fesë, gjuhës, ose llojit të familjes nga unë vij, qoftë ajo e varfër apo e pasur.

#### Neni 3: Interesat më të mira të fëmijës

Të gjithë të rriturit janë përgjegjës për atë që është më e mira për mua. Po ashtu edhe unë duhet të degjohem për atë që unë mendoj se është më e mira për mua.

#### Neni 4: Zbatimi i të drejtave të mia

Qeveritë janë përgjegjëse për vënien e këtyre të drejtave në dispozicionin tim.

#### Neni 5: Udhëzimi nga prindërit dhe familja ime për zhvillimin tim fizik, mendor dhe shoqëror

Unë kam të drejtë të marr udhëzime nga prindërit e mi dhe familja. Qeveria ime duhet të mbështesë familjen time për t’u kujdesur për mua dhe gjithashtu të respektojë pikëpamjet dhe shqetësimet e mia.

#### Neni 6: Mbijetesa dhe zhvillimi

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të jetojnë. Qeveria ime duhet të sigurojë që të gjithë fëmijët mbijetojnë dhe zhvillohen në shëndet të mirë. Unë kam të drejtë për të jetuar në një mjedis të sigurt dhe të lumtur.

#### Neni 7: Emri im dhe kombësia

Unë kam të drejtë të kem një emër. Unë kam të drejtë t’i përkas një kombësie. Unë kam të drejtë të di se cilët janë prindërit e mi dhe të kem përkujdesjen e tyre, nëse është e mundur.

#### Neni 8: Mbrojtja e identitetit

Unë kam të drejtën e një identiteti, që do të thotë të kem një emër, të jem pjesë e familjes sime dhe të kem një kombësi.

#### Neni 9: Ndarja nga prindërit e mi

Unë kam të drejtë të jetoj me prindërit e mi, përveç nëse prindërit e mi ose familja nuk janë të mirë me mua.

#### Neni 10: Ribashkimi familjar dhe integrimi në të njëjtin vend

Unë kam të drejtë të jetoj së bashku me prindërit e mi. Nëse prindërit e mi dhe unë jemi duke jetuar në vende të ndryshme, unë kam të drejtë të bashkohem me prindërit e mi dhe të jetoj në të njëjtin vend sikurse prindërit e mi.

#### Neni 11: Lëvizja e paligjshme dhe moskthimi

Askujt nuk i lejohet të më largojë nga vendi im me forcë ose në mënyrë të fshehtë.

#### Neni 12: Mendimi im

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë t’i shprehin mendimet e tyre. Unë duhet të pyetem për mendimet e mia. Mendimet e mia duhet të respektohen në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me mua, në shtëpi, në shkollë, nga qeveria ime dhe gjykatat.

#### Neni 13: Liria e shprehjes

Unë kam të drejtë të marr dhe të shkëmbej informacione, për deri sa këto informacione nuk janë mos respektuese ose të dëmshme për mua apo të tjerët. Unë kam të drejtë për të menduar dhe për të shprehur pikëpamjet e mia me gojë, me shkrim ose në mënyrë artistike.

#### Neni 14: Liria e mendimit, besimit dhe fesë

Unë kam të drejtë të mendoj dhe të besoj atë që unë dua dhe të praktikoj fenë time. Prindërit e mi duhet të më udhëzojnë në këto çështje.

#### Neni 15: Liria e shoqërimit

Unë kam të drejtë të takohem së bashku me njerëz të tjerë dhe të formoj apo t’u bashkohem shoqatave, për aq kohë sa nuk i ndaloj të tjerët të gëzojnë të njëjtat të drejta.

#### Neni 16: Mbrojtja e privatësisë

Unë kam të drejtën e privatësisë. Askush nuk duhet t’i lexojë letrat e mia, e-mailin ose ditarin pa lejen time.

#### Neni 17: Qasja në informacione të përshtatshme

Unë kam të drejtë të kem informacione përmes formave të ndryshme të medias, të tilla si radio, gazeta, televizioni dhe interneti. Unë gjithashtu duhet të jem i mbrojtur nga informacioni që mund të më lëndojë.

#### Neni 18: Përgjegjësitë e prindërve

Të dy prindërit e mi e ndajnë përgjegjësinë për të më rritur mua. Unë kam të drejtë për të jetuar me të dy prindërit e mi, nëse është e mundur.

#### Neni 19: Mbrojtja nga abuzimi dhe neglizhenca

Unë kam të drejtë të jem i mbrojtur nga çdo lloj dhune apo trajtimi i keq, duke përfshirë ndëshkimin fizik. Qeveria ime duhet të sigurohet që të gjithë fëmijët janë duke marrë përkujdesjen e duhur dhe duke u mbrojtur nga dhuna.

#### Neni 20: Mbrojtja e fëmijëve pa familje

Në qoftë se unë nuk mund të jetoj me prindërit e mi, unë kam të drejtë për mbrojtje dhe mbështetje të veçantë. Mua gjithashtu duhet të më jepet mundësia që të praktikoj fenë, kulturën dhe gjuhën time.

#### Neni 21: Birësimi

Në qoftë se unë jam birësuar, shqetësimi kryesor duhet të jetë ajo se çka është më e mira për mua. Të njëjtat rregulla vlejnë qoftë nëse jam i birësuar në vendin tim ose në një vend tjetër.